



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.701/22

GJYKATA KOMERCIALE -Dhoma e Shkallës së Dytë, me gjyqtaren individuale Saranda Bogaj Sheremeti , në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit me N.R.B me adresë Rruga, Fushë Kosovë, kundër debitorit Komuna e Gjilanit me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, CPK.nr.71/20, i datës 16.03.2021, me datë 24.08.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

ARPROVOHET e bazuar ankesa e debitorit Komuna e Gjilanit dhe ANULOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, CPK.nr.71/20, i datës 16.03.2021 *dhe lënda i kthehet në rishqyrtim dhe vendosje Gjykatës Komerciale-Dhomës së Shkallës së Parë.*

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar CPK.nr.71/20, i datës 16.03.2021, ka vendosur të refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit Komuna e Gjilanit ,i paraqitur kundër urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr. 2673/19, i datës 17.12.2019.

Kundër këtij aktvendimi me kohë ka parashtruar ankesë debitori për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës dhe konstatimit të gabuar të gjendjes faktike për çka i ka propozuar gjykatës se shkallës së dytë që ta aprovoi ankesën e debitorit , ta anuloj aktvendimin mbi lejimin e përmbartimit, dhe ta kthej lëndën në rivendosje.

Gjyqtarja individuale e Dhomës së Shkallës së Dytë në Prishtinë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me N.R.B me adresë Rruga, Fushë Kosovë, ka paraqitur propozim për përmbaram ndaj debitorit Komuna e Gjilanit në bazë të dokumentit të besueshëm- faturave të datës 03.07.2019-vlera 441 euro, 03.07.2019-vlera 500 euro, 04.09.2019-vlera 161.40 euro, 03.07.2019-vlera 32 euro dhe fatura e datës 24.11.2019-vlera 59.95 euro, me të cilat ka kërkuar që në emër të borxhit, t'ia paguajë shumën prej 1,194.35 Euro, si dhe shpenzimet e procedurës përmbaramore, duke përfshirë edhe pagesën e kamat- vonesave në vlerë prej 8% të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimi të këtij urdhri.

Përmbaramesi Privat Atip Mustafa duke vepruar sipas propozimit për përmbaram të kreditori ka lejuar përmbaramin me urdhrin P.nr. 2673/19, i datës 17.12.2019, ndërsa kundër këtij urdhri debitori ka ushtruar prapësim me datën 03.01.2020, duke theksuar se urdhri përmbaramor është mbështetur në fatura ku nuk mund të vërtetohet se nga kush janë pranuar, nga cili zyrtarë apo organ dhe se mund të jenë paguar në ndërkohë por që janë në proces të hulumtimit për ti siguruar drejtoritë përkatëse këtë argument. Ka shtuar se ky urdhër përmbaramor është pa bazë ligjore dhe në asnjë mënyrë nuk mund të vërtetohet ligjshmëria e këtij dokumenti përmbarames.

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori me datë 13.01.2020, duke theksuar se pretendimet e debitorit duhet të hedhen poshtë pasi që ne kemi bërë furnizimin konform kushteve dhe kriterëve të kontratës pas pranimi të kërkesave nga ana e njësive kërkuese ndërsa sa i përket faturave që nuk janë shënuar emrat e personave që kanë bërë pranimin e mallit është krejtësisht e pa bazë nga ana e debitorit sepse në të gjitha faturat është shënuar referenca se te kush dorëzohet malli, duke i propozuar gjykatës që ta refuzojë prapësimin e debitorit ndërsa urdhrin e përmbaramesit privat ta lejë në fuqi.

Gjykata Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm pas vlerësimit të prapësimi dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar CPK.nr.71/20, i datës 16.03.2021, ka vendosur që ta refuzoj prapësimin e debitorit, duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka theksuar se nuk janë plotësuar asnjëra nga shkaqet e parapara me nenin 71 të LPP-së, e po ashtu përmbaramesi privat e ka nxjerrë urdhrin përmbaramor në pajtim të plotë me dispozitën e nenit 29 paragrafi 1 pika 1.2, pasi që fatura paraqet dokument të besueshëm. Më tej ka theksuar se lidhur me pretendimet e debitorit se pa kurrfarë dokumenti përmbaramor është caktuar përmbarami gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se një pretendim i tillë është i pabazuar dhe i paqëndrueshëm, pasi që nga shkresat e lëndës sic janë faturat

e datës 03.07.2019-vlera 441 euro, 03.07.2019-vlera 500 euro, 04.09.2019-vlera 161.40 euro, 03.07.2019-vlera 32 euro dhe fatura e datës 24.11.2019-vlera 59.95 euro, në bazë të cilave është nxjerrë urdhri përmbarimor në bazë të nenit 29 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-së, konsiderohen dokumente të besueshme në bazë të cilave mund të caktohet përmbarimi nga organi përmbarues.

Andaj edhe ka vendosur që në kuptim të dispozitave të nenit 43, 73 pika 1, 2 dhe 3 të LPP-së, ta refuzojë prapësimin e debitorit si të pabazuar ndërsa urdhrin e përmbaruesit privat ta lejë në fuqi.

Dhoma e Shkallës së Dytë qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i ankimuar është përfshirë në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së, si dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale respektivisht nenin 360, paragrafi 1, pika 1.1 dhe 368 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së.

Gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së, kur ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit, duke e lënë në fuqi urdhrin e përmbaruesit privat P.nr. 2673/19, i datës 17.12.2019.

Dhoma e Shkallës së Dytë nuk mund ta pranojë këtë qëndrim të gjykatës së shkallës së parë, për faktin se nuk mund të kuptohet se si ka ardhur deri te një vendosje e tillë lidhur me faktin se faturat e datës 03.07.2019-vlera 441 euro, 03.07.2019-vlera 500 euro, 04.09.2019-vlera 161.40 euro, 03.07.2019-vlera 32 euro dhe fatura e datës 24.11.2019-vlera 59.95 euro mund të konsiderohen dokumente të besueshme në bazë të cilave mund të caktohet përmbarimi nga organi përmbarues, derisa asnjëra nga faturat të cilat gjenden në shkresat e lëndës nuk përmbajnë vulën e protokolimit nga ana e debitorit e kur dihet që institucionet publike në këtë rast kur debitor është Komuna duhet që të përmbajnë edhe vulën e protokolit si provë me të cilën vërtetohet pranimi i dokumenteve, në rastin konkret faturave.

Dhoma e Shkallës së Dytë gjeti se me dispozitën e nenit 29 paragrafi 1, pika 1.3 të LPP-së, përcaktohet se konsiderohen dokumente të besueshme në bazë të cilave mund të caktohet përmbarimi nga organi përmbarues edhe faturat, ndërsa në këtë çështje nuk është përmbushur dispozita e lartëpërmendur. Ndërsa pranimi me emër dhe mbiemër nga personi nuk paraqet bazë ligjore me të cilën do të konsiderohej se fatura është dorëzuar në mënyrë të rregulltë sepse sic është thënë më lartë në institucione shtetërore, ndërmarrje publike etj, çdo dokument duhet të dorëzohet dhe protokolohet në zyrën e pranimit përmes vulës protokolit

Andaj,në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë duhet të ketë parasysh vërejtjet e cituara me lartë, *duke i marr parasysh edhe pretendimet ankimore të debitorit në prapësim*, fillimisht të vlerësoj në mënyrë të drejtë nëse janë të ekzekutueshme faturat, e më pastaj ka mundësi të marr vendim të drejtë dhe të ligjshëm, të ftoj palët në seancë për të vërtetuar këtë fakt se a janë faturat të prokoluara , duke i zbatuar dispozitat ligjore në fuqi.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale dhoma e Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në bazë të nenit 77 ,29,dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË- Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.701/22, data 24.08.2022

Gjyqtarja
Saranda Bogaj Sheremeti